

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES
Nr. 657 Rep.
Nr. 347 Kol.



Vertetesi ligjore

NOTER
MARENGLLEN RRAPI
L.11, Rr. "Aleksander Goga", Tel.: 0692288932
Durres – ALBANIA

KONTRATE SHITBLERJE

"Kuota Sh.p.k - je"

Ne Durres, sot me daten **02 Maj 2012** (dymije e dymbedhete), dite e Merkure para meje Noterit Publik **MARENGLLEN RRAPI**, anetar i Dhomes Noterise Durres, paisur me Licens profesionale **Nr. 136 date 03.07.1997**, rregjistruar ne Q.K.R me **NIPT K 31604519 B**, u paraqiten personalisht shtetasit pale per lidhje te kesaj kontrate me keto cilesi ligjore dhe Identitete:

1. Pale Shitese: Z. PERPARIM BULICA, atesia Eshref, amesia Mereme, i datelindjes 02.01.1966, lindur ne Kukes dhe banues ne Rr. " Reshit Collaku" Ap. 1 Shkalla Nr. IV Pall. "Shallvaret" Tirane, Cel.: 0682021609, indentitetin e te cilit e verifikova me Leternjofimin 025182342 me afat deri me 02.05.2019.....

2. Pale Blerese: Personi Juridik Shoqeria Tregtare "**KASTRATI**" **Sh.A** Shkozet Durres, rregjistruar ne Q.K.R Tirane me NIPT K 21711502 V, me aksioner te vetem **Z.SHEFQET KASTRATI**, atesia Jonuz, amesia Lije, i datelindjes 05.06.1961, lindur ne Brrut- Kukes, shtetas shqipetar dhe banues ne L.1, Rr."Currlave" Durres identitet qe verifikova me Leternjofimin ID 027847509 me afat deri me 08.11.2019.....

Shtetasit jane madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.

BAZAT JURIDIKE TE KONTRATES


NENET: 6, 149, 705-708, 710, 711, 714, 719-723, 730 te KODIT CIVIL

Pas njohjes me permbajtjen e dispozitave juridike civile te mesiperme, me vullnetin e tyre te lire te plote, te sinqerte dhe mirekuptim te ndersjellte, palet lidhin kete Kontrate, sipas ketyre deklarimeve:

Une Pala Shitese, Perparim Bulica, jam ortaku i Shoqerise Tregtare, "**LIRA M.P**" Shpk, me seli Lezhe, Koder Spaç, Autostrada Durres – Kukes km 25, Godine 2 Kateshe.....

Shoqeria eshte e rregjistruar person juridik ne Q.K.R me Çertifikaten NIPT K 99530001 D, dhe ortak tjetër i kesaj shoqerie eshte edhe shoqeria anonime "Kastrati" Sh.a, me seli ne lagjen 14 Shkozet Durres e cila ka ortak te vetem **Z. Shefqet Kastrati**

Kapitali themeltar i Shoqerise "**LIRA M.P**" eshte **100.000 lek**, ku ne momentin e formimit dhe nenshkrimin te tij une ortaku **Perparim Bulica** kam dhene nje kontribut ne masen **20%** te formimit dhe nenshkrimin te kapitalit, i ndare ne **20 kuota** me vlere nominale **1.000 lek/I kuote, qe zene 20 %** te Kapitalit Themeltar edhe ortak tjetër personi juridik "**Kastrati**" **Sh.a.** ka dhene nje kontribut ne masen **80%**, ne formimin dhe nenshkrimin e ketij kapitali themeltar, i ndare ne 80 kuota me vlere nominale **1.000 lek/I kuote, qe zene 80 %** te Kapitalit Themeltar.....



02.

Bazuar ne STATUTIn e shoqerise "LIRA M.P" dhe te drejten e disponimit qe parashikon neni 149 i Kodit Civil dhe duke respektuar kerkesen per te drejten e parablerjes te paraqitur nga ortaku tjetër i shoqerise qe eshte shoqeria anonime "KASTRATI" Sh.a te gjithë vleren ne shumen 20.000 Lek qe perben 20 % te Kapitalit themeltar e barabarte me 20 Kuota Sh.p.k-je me te drejte vendimore te Shoqerise, "LIRA M.P" Sh.p.k une Perparim Bulica, ia shes, brenda ortakerise shoqerise anonime "KASTRATI" Sh.a me aksioner te vetem Shefqet Kastrati, me te njenjten vlere nominale kuotash, me koeficientin 1000 Lek/1 kuote qe arrin shumen 20.000 lek, duke mu bere pagesa nga ana e tij Cash per te gjithë vleren e ketyre kuotave

Pala Blerese Shoqeria aninime "KASTRATI" Sh.a deklarone se eshte plotesisht dakord, qe te blej nga ortaku i shoqerise "LIRA M.P" Sh.p.k, te gjitha kuotat e kapitalit themeltar, ne pronesi te pales shitesë Perparim Bulica, gjithsej 20 kuota sh.p.k-je qe perbejne si vlere shumen 20.000 leke, dhe qe zene 20 % te Kapitali themeltar dhe se te gjithë shumen e lekeve, ne vleren 20.000 lek ia ka parapaguar Cash, Pales Shitesë **Z. PERPARIM BULICA**, jashte kesaj zyre, fakt qe konfirmohet me deklarim pohues para meje Noterit dhe nga vete Pala Shitesë.....

Me nenshkrimin e kontrates, Pala Shitesë **Z. PERPARIM BULICA**, humbet plotesisht PRONESIN mbi 20 kuota te kapitalit themeltar ne shumen 20.000 Lek, qe zene 20 % te kapitalit themeltar, ndersa shoqeria anonime "KASTRATI" Sh.a me aksionet te vetem **Z. Shefqet Kastrati**, fiton titullin e pronesisë dhe mbi 20 % te kapitalit themeltar dhe behet zoteruese e vetme e pronesisë e te gjithë kuotave te kapitalit themeltar ne shumen 100.000 Lek qe jane barabarte me 100 kuota shp.k-je te kapitalit themeltar

Me shitjen e te 20 % te kuotave te kapitalit themeltar nga pala shitesë Perparim Bulica humbet plotesisht statusin juridik te qenesise te metejshme ortak i shoqerise tregtare "LIRA M.P" dhe pala blerese shoqeria "Kastrati" Sh.a, fiton statusin juridik te ortakut te vetem te shoqerise "LIRA M.P" Sh.p.k

Kontrata, me kerkesen e paleve, u redaktua ne 4 ekzemplare, ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njenjta juridike dhe pasi lexohet me ze nenshkruhet nga Palet duke vene emrin mbiemrin dhe firmen origjinale. Une Noteri legalizoj redaktimin korekt dhe vertetoj autenticitetin e nenshkrimeve me cilesin qe me nje e vene emrin dhe mbiemrin origjinal forme nenshkrimi kjo e percaktuar nga neni 46/1 i Ligjit Nr.7829 dt.01.06.1994 "Per Noterin"

PALE SHITESË

Zoterues ne masen 20 % te Kapitalit Themeltar

z. Perparim Bulica

PALE BLERESE

Zoteruese ne masen 80 % te Kapitalit Themeltar
Shoqeria tregtare "Kastrati" Sh.a
Aksioneri i Vetem

z. Shefqet Kastrati



NOTERI

MARENGLËN RRAPI

(Handwritten signature of Marenglen Rrapi)